



Republika e Kosovës/  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova -  
Kosovo Agency of Statistics*

**Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

## **Anketa e Mbeturinave Industriale 2012**







Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova -  
Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

# **Anketa e Mbeturinave Industriale 2012**



Botuesi: Agjencia e Statistikave së Kosovës (ASK)

Data e botimit: Dhjetor 2013

© : Agjencia e Statistikave së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata më të detajuara gjenden në ueb-faqen:

<http://esk.rks-gov.net/>

## **P a r a t h ë n i e**

Ky është publikimi i tretë me radhë që Agjencia e Statistikave të Kosovës ka organizuar dhe realizuar për statistikat e mbeturinave nga industria sipas NACE Rev.1.1.

Objektivi kryesor i këtij studimi është që të ofrojë të dhëna për mbeturinat nga sektori industrial në Kosovë. Rezultatet e paraqitura në këtë botim janë burim i rëndësishëm statistikorë për mbeturinat e gjeneruara dhe përpunuara nga sektorët e industrisë C, D dhe E.

Instrumentet statistikore të përdorura gjatë këtij hulumtimi janë në përputhje me Rregulloren (EC) Nr 2150/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 Nëntorit 2002 mbi statistikat e mbeturinave, Listës Evropiane të Mbeturinave dhe Ligjit për Mbeturina në Kosovë, (Nr. 02 / L-30) të dizajnuara sipas rregulloreve të Bashkimit Evropian.

Falënderimet i dedikohen ekspertit nga GOPA Jürgen Gonser (ARGUS GmbH, Berlin) për mbështetje profesionale.

Ky publikim u përgatit nga:

Z.Bajrush Qevani, Drejtor DSBM

Z.Haki Kurti, Mr,sc. Shef i Divizionit SM

Zonja.Teuta Ademi, Zyrtare SM

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet për këtë publikim janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen me e-mail [agriculture@ks-gov.net](mailto:agriculture@ks-gov.net)

Prishtinë, Dhjetor 2013

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së  
z. Isa Krasniqi

### **Shkurtesat dhe Simbolet**

BE	-	Bashkimi Evropian
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NACE rev.1.1.	-	Klasifikimi i Aktiviteteve Ekonomike
EWCSStat.Classification.		Katalogu Evropian i Mbeturinave
LoW	-	Lista e Mbeturinave
DSBM	-	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

### **Simbolet**

T	-	Ton
%	-	Për qindje

## Përmbajta

	Faqe
Informacione të përgjithshme .....	5
Objektivat dhe metodologjia e anketës .....	5
Metodologjia.....	6
Mbledhja e të dhënave.....	7
Definicionet.....	7
Rezultatet.....	8
Rezultatet anketa 1.....	10
Rezultatet anketa 2.....	13
Aneks 1.Pyetëtori.....	15





## **Informacione të përgjithshme**

Anketa e mbeturinave industriale në Kosovë u realizua sipas NACE Rev.1.1, i cili njëkohësisht është dhe klasifikim statistikor i aktiviteteve ekonomike. Mbeturinat janë klasifikuar si të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, sipas listës së mbeturinave.

Njësi raportuese janë të gjitha kompanitë me shtatë ose me më shumë punëtorë. Gjithashtu në mostrën e rastit janë përfshirë edhe popullsia e kompanive të vogla me më pak se shtatë punonjës. Kompanitë e përfshira janë klasifikuar nga NACE Rev.1.1 në sektorët e aktiviteteve vijuese: Miniera dhe Gurorë (C), Industria e prodhimit (D) dhe Energjia elektrike (E).

## **1. Objektivat dhe metodologjia e anketës**

### **1.1 Objektivi**

Qëllimi i anketës së mbeturinave industriale 2012 ka qenë që të siguroj të dhënat për mbeturinat e gjeneruara nga industria. Të dhënat u mbledhën për dy kategori: Mbeturina të gjeneruara dhe Mbeturina të përpunuara.

Objektiv i AMI 2012 ka qenë realizimi i anketimit për mbeturinat nga industria, për grupet NACE: C (Miniera dhe Gurorë), D (për Prodhim) dhe E (Energjisë).

Gjithashtu qëllim i anketës ka qenë, që anketimi të realizohet në përputhje me kërkesat kombëtare dhe në harmoni me rekomandimet ndërkombëtare.

## 1.2 Metodologjia

### 1.2.1 Korniza e anketës

Të gjitha procedurat e hulumtimit dhe përgatitja e instrumenteve statistikore janë finalizuar gjatë muajit korrik 2013.

Mbledhja e të dhënave është kryer gjatë muajit gusht 2013, ndërsa intervistimi është realizuar sipas metodës ballë për ballë.

Plani i punës ka pasur këto faza: Fazën përgatitore, të mbledhjes, përpunimit të të dhënave dhe faza e botimit-publikimit.

Gjatë fazës përgatitore janë kryer këto aktivitete : mostra e anketimit, pyetësi, variablat, plani kohor, manuali për intervistuesit, trajnimi i intervistuesve dhe ndërtimi i bazës së të dhënave. Mostra është përgatitur sipas regjistrit statistikor për biznes në dy nivele (anketa 1 dhe 2).

Trajnimi është mbajtur një ditë në ASK, për të gjithë anketuesit të cilët kanë qenë të angazhuar në mbledhjen e të dhënave.

Korniza e mostrës sipas ASK-së dhe regjistrit të biznesit ka qenë 3835 kompani në sektorët e mostruar.

Mostra e AMI 2012 është përberë prej 864 bizneseve. Numri i përgjithshëm i bizneseve të cilat janë përgjigjur në anketë ka qenë 705.

Anketa një është përberë nga 610 kompani me shtatë ose më shumë punëtorë (nga mostra një, në anketë janë përgjigjur 490 biznese) .

Anketa dy është përberë nga 254 kompani me më pak se shtatë të punësuar. Përfshirja e mostrës dy, në hulumtim ka për qëllim arritjen e mbulueshmërisë më të madhe të bizneseve (nga mostra dy në anketë janë përgjigjur 215 biznese).

## 1.2.2 Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave ka përfunduar nëpërmjet intervistimit ballë për ballë, me menaxherët e kompanive industriale që veprojnë në rajonin përkatës, bazuar në pyetësorë (Shtojca 1).

Të gjithë pyetësorët janë kontrolluar për kontrollin e cilësisë në ASK, nga ekspertët e Divizionit të Statistikave të Mjedisit.

## 2. Definicionet

**Mbeturinat industriale:** mbeturinat e gjeneruara nga sektori i industrisë.

**Mbeturinat jo të rrezikshme,** mbetjet të cilat nuk paraqesin ndonjë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

**Mbeturinat e rrezikshme:** mbetje e cila sjell dëm dhe rrezik për shoqërinë, e cila tregon rrezik domethënës për shëndetin njerëzor apo mjedisin kur nuk menaxhohet në mënyrë adekuate. Mbeturinat e rrezikshme janë të ndezshme, gërryese, reaktive ose toksike. Mbeturinat e rrezikshme - janë mbeturinat të cilat kanë të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

- shpërthyes, oksidante, djegëse, irrituese, e keqe, toksike, kancerogjene, gërryese, infektuese, teratogjerike, mutagjene, emetuese, gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin ose një acid, ka të ngjarë të prodhojë substanca tjera të rrezikshme, dhe eko toksike
- Sipas Ligjit për Mbeturinat në Kosovë, (Nr.02/L-30).

### 3. REZULTATET E ANKETËS SË MBETURINAVE NGA INDUSTRIJA 2012

Rezultatet nga AMI 2012, tregojnë se nga industria, përkatësisht nga sektorët e aktiviteteve vijuese; Minierat dhe Guroret (C), Industria e prodhimit (D) dhe Energjia elektrike (E) janë gjeneruar 412 704 ton mbeturina dhe 526 ton mbeturina të rrezikshme.

Tabela 3.1: Gjithsej sasia e mbeturinave të gjeneruara nga sektorët e industrisë (anketa 1 dhe 2)

Anketa	Lloji i Industrisë	Gjithsej Mbeturina të gjeneruara	Mbeturina të rrezikshme	Mbeturina të përpunuara <sup>1</sup>
		Ton		
1	C, D, E	411,429	526	357,120
2		1,275	-	1,271
Gjithsej		412,704	526	358,391

Tabela 3.1. Tregon se sasia më e madhe e mbeturinave të gjeneruara ka qenë nga anketa një. Gjithashtu nga tabela vërehet se mbeturinat e rrezikshme janë gjeneruar nga anketa një.

<sup>1</sup>Trajtimi, përfshin proceset fizike, kimike, biologjike, termike, duke përfshirë klasifikimin, ndryshimin e karakteristikave të mbeturinave në mënyrë që të zvogëlohet vëllimi i saj i natyrës së dëmshme, lehtësimin për manipulim me mbeturina ose riciklim

Tabela 3.2 Mbeturina të gjeneruara NACE grupi (anketa 1 dhe 2)

Nace rev 1.1 Grupi	Mbeturina të gjeneruara/ ton		Gjithsej
	Anketa 1	Anketa 2	
14	177,171	14	177,185
15-16	55,674	55	55,729
17-19	6,500	10	6,511
20-22	3,166	175	3,341
23-25	1,688	35	1,723
26	5,297	70	5,368
27-29	5,769	81	5,850
30-35	350	15	365
36	1,243	5	1,247.50
37	3,250	811	4,061
40	150,053	3	150,056
41	1,269	0	1,269
	411,429	1,275	412,704

## 4. REZULTATET

### Anketa 1

Rezultatet nga anketa një tregojnë se, sasia më e madhe e mbeturinave të gjeneruar është në sektorin Miniera dhe Gurorë 177 171 ton ose 43% (sektori C) e gjithsej sasisë së mbeturinave të gjeneruara (mbeturina nga anketa një, 490 biznese të cilat janë përgjigjur në anketë). Nga sektori E, janë gjeneruar 151 322 ton mbeturina ose 37%. Ndërsa në sektorin D, janë gjeneruar 82 936 ton mbeturina ose 20%.

Tabela 4.1: Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me shtatë ose më shumë punëtorë

Lloji i industrisë	Gjithsej Mbeturina të gjeneruara	Mbeturina të rrezikshme
	Ton	
C- Miniera dhe Gurorë	177,171	40
D- Prodhimi	82,936	485
E-Furnizimi me energji elektrike, gas, avull dhe uji të nxehtë	151,322	1.10
Total	411,429	526

Grafiku 4.: Struktura e mbeturinave të gjenerura nga industria, sipas kompanive me shtatë ose më shumë punëtorë dhe llojit të industrisë

Struktura e mbeturinave të gjenerura 2012 (C,D,E) në %




Tabela 4.2:Përpunimi i mbeturinave sipas llojit të industrisë (anketa1)

Nace rev.1.1	Gjithsej Mbeturina te gjeneruara	Mbeturina të marrura nga kompanite tjera për trajtim	Të djegura (përfshirë edhe ato për prodhimin e energjisë )	Të ripërdorura dhe rigjeneruara (pa përfshirjen e atyre për prodhimin e energjisë)	Deponuar	Dërguar diku tjetër	Gjithsej Mbeturina të përpunuara
14	177,171	-	2	557	175,752	252	176,562
15-16	55,674	213	1	105	2,110	10,765	13,194
17-19	6,500	-		29	2	305	336
20-22	3,166	50	829	903	683	697	3,162
23-25	1,688	24	2	953	279	337	1,595
26	5,297	-	3	1,975	1,422	1,896	5,296
27-29	5,769	-	0	551	-	14	565
30-35	350	-		17	10	320	347
36	1,243	41	163	311	-	716	1,231
37	3,250	-		3,250	-		3,250
40	150,053	-	1	-	150,050	2	150,053
41	1,269	-		-	20	1,259	1,279
Total	411,429	328	1,000.6	8,650.4	330,328.1	16,562.6	356,870

Tabela 4.2.Tregon se sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara ka qenë nga industria Miniera dhe Gurore dhe nga Energjia elektrike, gasi, avulli dhe uji i nxehtë (E 40).



## 5 REZULTATET

### Anketa 2

Rezultatet nga anketa dy, tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave të gjeneruar ka qenë në sektorin e prodhimit (D) 1 258 ose 99%, nga gjithsej sasia e mbeturinave të gjeneruara (anketa dy, 215 biznese janë përgjigjur në anketë), ndërsa 1% e mbeturinave është gjeneruar nga sektori Miniera dhe Gurore, (Anketa dy është përberë nga bizneset me më pak se shtatë punonjës).

Tabela 5.1: Mbeturina të gjeneruara 2012 (anketa dy, 215 biznese që janë përgjigjur anketës).

Lloji i industrisë	Mbeturina të gjeneruara
	Ton
C- Miniera dhe Gurore	14.00
D- Prodhimi	1,258
E-Furnizimi me energji elektrike, gas, avull dhe uji të nxehtë	3.00
Gjithsej	1,275

Tabela 5.2:Përpunimi i mbeturinave sipas llojit të industrisë (anketa 2).

Nace rev.1.1	Gjithsej Mbeturina te gjeneruara	Të marrura nga kompanite tjera për trajtim	Të djegura (përfshirë edhe ato për prodhimin e energjisë)	Të ripërdorura dhe rigjeneruara (pa përfshirjen e atyre për prodhimin e energjisë)	Deponuar	Dërguar diku tjetër	Gjithsej Mbeturina të përpunuara
14	14.0	-	-	3.5	-	-	3.5
15-16	55.4	-	0.3	5.3	-	39.8	45.4
17-19	10.4	-	1.4	4.9	1.0	3.1	10.4
20-22	174.6	-	27.4	9.2	95.0	4.0	135.6
23-25	34.7	-	0.3	189.3	1.5	11.6	202.7
26	70.4	-	1.6	20.3	36.0	12.5	70.4
27-29	81.3	-	2.1	16.7	26.8	35.6	81.2
30-35	14.6	-	1.6	2.5	0.6	8.9	13.6
36	5.0	-	2.0	-	-	3.0	5.0
37	811.3	-	-	-	700.0	-	700.0
40	3.0	-	-	-	3.0	-	3.0
41	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	1,275	-	36.7	251.6	863.9	118.4	1,270.7

Tabela 5.2. Tregon se sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara ka qenë nga sektori i prodhimit D.

## Aneks 1 Pyetëtori



Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

628.54 (496.51)“2012”(084.2)

Anketa e Mbeturinave Industriale : 2012 / [Publikimin e përgatitën Bajrush Qevani, Haki Kurti, Teuta Ademi]. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013. - 16 f. : ilustr. ; 28 cm. - (Seria 2 : Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit)

Parathënie / Isa Krasniqi: f. [II]

1. Qevani, Bajrush 2. Kurti, Haki 3. Ademi, Teuta

**ISBN 978-9951-22-021-7**

## **Agjencia e Statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër**

**Agjencia e Statistikave të Kosovës**, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Misioni i Entit**, është që të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë. Në vijim e sipër është përgatitja për Regjistrimin e Bujqësisë në Kosovë.

**Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës**  
**Rr. "Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**  
**Telefonat: +381 (0) 31 104**  
**Kryeshefi ekzekutiv : +381 (0) 38 200 31 112**  
**Fax: +381 (0) 38 235 033**  
**E-mail: [agricultural@ks-gov.net](mailto:agricultural@ks-gov.net)**  
**Ueb-faqe: <http://esk.rks-gov.net>**

ISBN 978-9951-22-021-7



9 789951 220217